



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec
RAHOVEC / GRAHOVAC

Njësi Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/126 Nr. ifaq/Br.str/No.pg 06

Data/Date 24.03.2026

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit për Azil Nr. 06/L-026 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8/2018"), Rregulloren (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve, Rregulloren (QRK) Nr.22/2020 Për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar, Strategjinë për Migrim 2021 - 2025 të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 24.03.2026 miraton këtë :

V E N D I M

Për miratimin e Planit komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Rahovecit 2026 - 2028

1. Me këtë vendim **miratohet** Plani komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Rahovecit 2026 - 2028.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Rahovecit 2026 – 2028.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Zyra Komunale për Komunitet dhe Kthim në Komunën e Rahovecit.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Shërbimit të Kuvendit,
- ZKKK-së,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.126/26
Datë:24.03.2026



Fatmir Iska

Kryesues i Kuvendit